



01 Nr. 404/26 Dt. 03.09.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejin e mjeteve financiare

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për lejin e mjeteve financiare për pagesë të shpenzimeve të krijuara për përgatitjen e materialeve promovuese dhe reklamuese që kanë për qëllim promovimin dhe prezantimin e Komunës së Prizrenit si “Qytet Evropian i Sportit”, kështu që, për këtë qëllim, dhe në emër të pagesave të faturave përkatëse, lejohen mjetet e nevojshme financiare në shumën prej 240.72 € (dyqind e katërdhjetë euro e shtatëdhjetë e dy cent).
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.
3. Mjetet e lartcekura do të lejohen pas parashtrimit të faturave përkatëse.
4. Obligohet Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

- Vendimi iu dërgohet
- Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

